

**PROJEKTI PËR KONKURRUESHMËRI LOKALE DHE  
RAJONALE**

**Lista e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Shoqëror  
HOTELI TIM'S Apartments, Shkup – rindërtim dhe përmirësim**

**shtator, Shkup**

## 1. Hyrja e projektit

Projekti për Konkurrueshmëri Lokale dhe Rajonale (PKLR) është një operacion investimi katërvjeçar, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, me shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPA II, i rezervuar për konkurrueshmëri dhe inovacion në Maqedoni. PKLR do të drejtohet si një Fond i Besueshëm Hibrid (Hybrid Trust Fund) dhe përmban katër komponentë, si dhe do të zbatohet nga Banka Botërore dhe Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Projekti do të ofrojë financim investues dhe ndërtim kapacitetesh për të mbështetur rritjen e këtij sektori, investim në destinacionet dhe përparim të një destinacioni të caktuar. Në nivelin rajonal dhe atë lokal, Projekti do të mbështesë destinacionet e përzgjedhura të turizmit në vend, me anë të kombinimit të asistencës teknike në përmirësimin e menaxhimit të destinacioneve, investimet në infrastrukturë dhe investimet në lidhjet dhe inovacionet. Investimet do të shtjellohen përmes një skeme granti për vepruesit rajonal në fushën e turizmit, siç janë komunat, institucionet, OJQ-të dhe sektori privat.

Ky Plan i Menaxhimit Mjedisor dhe Shoqëror (PMMSH) u zhvillua për aktivitetet që do të zbatohen nga Hoteli TIM'S SHPK, Shkup. Lista e Kontrollit e PMMSH prezanton përshkrimin e projektit, detajet teknike, shtrirjen, vendosjen dhe vendndodhjen, në bazë të të cilave ka vlerësuar rreziqet mjedisore dhe shoqërore.

Implementimi i masave të zbutjes që adresojnë rreziqet dhe çështjet e identifikuara, si dhe plani i monitorimit i përcaktuar me Listën e Kontrollit të PMMSH është i detyrueshëm, njëjtë si dhe respektimi i normave ligjore të brendshme që lidhen me mjedisin, dhe normave tjera, dhe me politikat e punës së Bankës Botërore.

## 2. Përshkrimi i shkurtër i projektit

Nën-projekti parashikon disa faza: ndërtimi i një kati/plafoni plotësues, i lart 2.74m, apo +14.76m nga ±0.00 niveli i lartësisë nga niveli i rrugës (niveli aktual është +14.02), që përfshin rregullimin e dy apartamenteve plotësuese (me dimensione nga 33.75m<sup>2</sup> dhe 21.50m<sup>2</sup>), plus sipërfaqja plotësuese e komunikimit (shkallë, zonë gjysmë-zbritëse dhe zbritëse) nga 14.70m<sup>2</sup>. Kjo gjë rrit dhe kapacitetin e shtretërve të hotelit me dy (2) shtretër plotësues, nga 42 shtretër ekzistues. Ky kat/plafon do të jetë një plotësim i ndërtimit të mëhershëm, mirëpo me vetëm gjysmën e sipërfaqes së plotë të tij, që do të thotë se gjysma tjetër do të mbulohet me strukturë kulmi.

Arsyeja kryesore për këtë nën-projekt të rindërtimit e kulmit është plotësimi i një kulle elevatori për një ashensor i cili duhet të marrë 6 persona, gjë kjo e cila kërkon një nivel plotësues për komponentët mekanikë dhe elektrikë të ashensorit. Përveç faktit se investuesi shfrytëzon mundësinë e ngritjes së kapacitetit të hotelit me dy dhoma dhe mbulimit të gjysmës tjetër të katit me kulm, duke bërë të mundur kështu hapësirë për ngritjen e kapacitetit në të ardhmen, nëse do të shfaqet nevoja. Për momentin, hoteli ka vetëm një ashensor shërbimi që merr më së shumti 2 persona dhe shfrytëzohet vetëm për mirëmbajtjen e dhomave. Ky ashensor do të mbetet në gjendjen e tij të mëhershme dhe do të udhëtojë në

rutën e tij ekzistuese nëpër katet e hotelit, që do të thotë se nuk do të udhëtojë në ndonjë nivel plotësues drejt katit të sapo ndërtuar.

Fazat tjera përfshijnë rindërtimin e dhomave, me anë të rrëzimit disa nga muret e brendshme, duke përmirësuar kështu kapacitetin e hotelit me edhe nga një dhomë për kat, si dhe cilësinë e klientëve-të ftuarve të tij. Rindërtimi i dhomave përfshin disenjimin dhe prokurimin e mobiljeve të reja, aparateve, pajisjeve të ndriçimit, pajisjes për banjë. Disenji i brendshëm/rinovimi do të ndahet në disa faza, si më poshtë:

- \* Çmontimi/heqja e mobilieve ekzistuese, qilimave, pikturave, pajisjes së ndriçimit, pajisjeve elektronike, pajisjeve të banjës, e orendive të fiksuara, etj.;

- \* Rrëzimi i strukturave ekzistuese të dhomave, duke përfshirë dhe çmontimin e dyerve. Pothuajse 80% të mureve ekzistuese (muret e thata dhe muret e shtruar me tulla) do të hiqen;

- \* Instalimi i pajisjeve elektrike, të ujërave dhe mbeturinave, të ventilimit brenda banjave, instalimet dhe pajisjet e ngrohjes dhe ftohjes, instalimet diellore dhe pajisjet për ngrohjen e ujit, instalimet e tjera elektrike sipas nën-projekteve, për instalimet elektrike, instalimet mekanike, instalimet e sistemit të ujit dhe kanalizimeve, instalimet diellore;

- \* Ndërtimi i strukturave të reja të murit dhe vrimave të derës (teknika/programi i mureve të thata)

- \* Vendosja e tjegullave të murit dhe dyshemesë në banjat, sipas disenjit të parazgjedhur;

- \* Vendosja e dyshemesë së drurit sipas materialeve të parazgjedhura;

- \* Instalimi i ndriçimit, sipas disenjit/zgjidhjes së parazgjedhur;

- \* Ngjyrosja apo dekorimi i elementeve të murit, tavanit dhe konstruksionit;

- \* Instalimi i dyerve dhe kornizave të dyerve në dhomat, sipas programit të parazgjedhur;

- \* Instalimi i pajisjes së re të banjës dhe orendive të fiksuara sipas programit të parazgjedhur;

- \* Montimi i orendive (krevate/krevate të dyfishta, dollapë nate, korniza të prapme muri, tavolina televizori, tavolina makijazhi, karrige, dollapë valixhesh, dollapë rrobash), sipas programit të parazgjedhur të disenjit të brendshëm. Orenditë janë bërë sipas projektit të disenjimit të brendshëm, nga kombinimi i dërrasave si konstruksioni kryesor dhe dekorimet nga dërrasat MDF dhe konstruksionet e çelikut, të përfshira me orendi të fiksuara plotësuese të karpentierisë, nyje, mbajtëse, dorëza, etj.

- \* Instalimi i aparateve dhe pajisjeve tjera (pasqyre, mini-bare, mini-kupola, TV LED, piktura, perde, etj.)

- \* Është përfshirë dhe përmirësimi i hapësirave të recepcionit dhe restorantit, si dhe hapësirat e shërbimit nën-nivelor dhe të konferencave. Do të bëhet një disenj i ri i brendshëm i restorantit, që do ta ndryshojë sipërfaqen e dyshemesë, pajisjet e ndriçimit të tavanit,

tavolinat dhe karriget e reja për të ftuarit, të përzgjedhura nga projekti i disenjimit të brendshëm, banaku i kuzhinës/tavolina e shërbimit dhe elementet e sipërme të bëra nga dërrasa, në kombinim me dërrasa MDF dhe profile çeliku, tavolinë e re e recepcionit e bërë nga dërrasa MDF dhe konstrukcion çeliku, e pajisur me pajisje elektronike, siç janë një printer/faks/skaner, kompjuter personal, karrige për të punësuarit, tavolinë me mbështetëse për duart për lobin e hotelit, etj.

Rikonstrukcioni i kapaciteteve të hotelit është ndarë në disa faza dhe nën-faza, të cilat përfshijnë punime përgatitore, çmontime, ndërtime, punë artizanale, vendosje të orendive dhe pajisjeve.

### **Faza e ndërtimit:**

Kjo fazë është faza fillestare, së bashku me nën-fazat e saja, si këto më poshtë:

**Punimet përgatitore** të cilat do të bëjnë heqjen e orendive ekzistuese, materialeve të karpentierisë, veshjen e dyshemeve, pajisjet e fiksuara të ndriçimit, pikturat, perdet, njësitë e ajrit të kondicionuar, radiatorët e ngrohjes avullore, dritaret PVC, dyert, pajisjet sanitare dhe objektet dhe materialet tjera.

Nën-faza vijuese është **faza e çmontimit** e cila ka të bëjë me muret ekzistuese midis dhomave dhe apartamenteve, konstrukcionin e kulmit, instalimet e ujit dhe kanalizimit, ventilimet, hapjen e kullës së ashensorit në konstrukcionin ekzistues nëpër të gjitha katet. **Pastrimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe dërgimi i tyre në një depo të ligjshme**, pas dhe gjatë kompletimit të nën-fazave që përmenden në këtë kapitull.

**Punimet e karpentierisë** apo vendosja e dyerve të dhomave është një fazë e cila përfshin blerjen dhe instalimin e dyerve të hyrjes dhe të brendshme, me pajisje dhe orendi të plota për standardet e hotelit.

**Punimet qeramike** që kanë të bëjnë me blerjen dhe vendosjen e dyshemesë dhe mureve qeramike nëpër hapësirat e hotelit (banjat, recepcioni, restoranti, hyrja e hotelit). Duke përfshirje dhe banjat e dhomave, janë gjithsej 28 dhoma sanitare, (22 banja, 2 tualete me hapësirë parahyrëse për restorantin, 1 banjë për punëtorët, 2 tualete dhe hapësirë parahyrëse për sallën e konferencave dhe 1 banjë për stafin e pastrimit).

**Punimet e dyshemesë** që kanë të bëjnë me blerjen dhe vendosjen e dyshemeve të drurit në hapësirat e dhomave, me dërrasa dyshemeje që arrijnë gjithsej 460m<sup>2</sup> sipërfaqe dyshemeje.

**Blerja e pajisjeve sanitare** ka të bëjë me instalimin e pajisjes në banjat në të gjitha 22 dhomat e hotelit (lavamanët e banjave, tualetet, kabinat e dushit, rubinetet, mbajtëset e peshqirëve, pasqyrat, etj.).

**Punimet ndërtimore dhe suvatimet** – rinovimi i të gjitha mureve, plafonëve dhe sipërfaqeve të konstrukcionit nëpër hotel, si faza përfundimtare e të gjitha punimeve ndërtimore dhe instalimeve, që përfshin një sipërfaqe nga 2.150m<sup>2</sup>.

**Punimet e aluminit** kanë të bëjnë me prokurimin dhe vendosjen e dyerve, dritareve dhe portave nëpër hapësirat e hotelit.

**Punimet e çelikut** në konstruksionin e ri për katin/plafonin, parrmakët e shkallëve, shenja e hotelit, përshtatja e ballkoneve ekzistuese në sipërfaqen e dhomës së re, duke shtuar 8.3m<sup>2</sup> plotësuese për dhomë në të gjitha 4 katet ekzistuese, përveç katit të shtuar;

#### **Blerja dhe instalimi i ashensorit;**

Rindërtimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të hotelit ka nevojë për instalimin e një ashensori me kapacitet për 6 persona. Janë përfshirë instalimi dhe testimi i tërë pajisjes.

Ky instalim përfshin:

- Hapjen e një kulle të re të ashensorit, duke hequr pllakat e katit të ndërtimit;
- Instalimi i pajisjes së ashensorit;
- Kapaciteti 450kg/6 persona; shpejtësia 1.0m/sek.; dimensionet e kullës 1800x1200mm  
lartësia e udhëtimit 18000mm; vrima 400mm; 7 stacione; fuqia 380V/220V – 50Hz

#### **Prokurimi dhe vendosja e instalimit diellor dhe sistemit të ngrohjes së ujit**

Përmirësimi i instalimeve të hotelit përfshin një sistem të ri bashkëkohor për ngrohjen e ujit. Ky sistem do të pakësojë shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike dhe do të ofrojë një ambient ekologjik për rrethin.

Ky sistem përfshin:

- Dy (2) boilerë me kapacitet 1000l për ngrohje të ujit sanitar, me ngrohës që punon me panele diellore dhe një ngrohës tjetër për pompën e ujit dhe ngrohës elektrikë 3x3kW;
- Dhjetë (10) kolektorë fotovoltaike me absorbues selektiv qelqi, secili nga ato 2.5m<sup>2</sup>, që ngrohin ujin në boilerët nga 1000l;

#### **Prokurimi dhe instalimi i sistemeve të kondicionerit**

Përmirësimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes së hotelit do të ndryshojë plotësisht me instalimin e njësisve të ajrit të kondicionuar në tavan, që do të zëvendësojnë radiatorët e vjetër avullorë dhe kondicionerët me kapacitet të ulët. Sipas specifikimeve teknike, pajisjet janë si më poshtë:

- Pompë e ngrohjes/ftohjes, 33kW për ftohje dhe 37.5kW për ngrohje – 3 copë
- Kasetatavani me spirale ventilimi me katër kanale 5,0/5,6kW – 2 copë
- Kasetatavani me spirale ventilimi me katër kanale 5,6/6,3kW – 1 copë
- Kasetatavani me spirale ventilimi me një kanal 2,2/2,5kW – 1 copë
- Kasetatavani me spirale ventilimi me një kanal 2,8/3,2kW – 16 copë
- Kasetatavani me spirale ventilimi me një kanal 3,6/4,0kW – 13 copë
- Spirale ventilimi në tavan me kartë muri – 24 copë
- Ndarës FQ – 30 copë
- Kontrollues i sistemit të mençur

### **Instalimet elektrike**

Kompletimi i rindërtimit të instalimeve elektrike nëpër tërë hotelin në çdo nivel, si instalime me fuqi të vogël dhe me fuqi të madhe, duke përfshirë instalimet e detektimit dhe mbrojtjes nga zjarri, kontrolli i hyrjes në dhomë, rrjeti i telefonit dhe internetit, vëzhgimi video, instalimi i zërit, instrumentet e detektimit, butonat, prizat e murit, etj. Mbetjet nga instalimet e vjetra dhe pajisjet dytësore, siç janë instrumentet e detektimit, grykat e fiksuara të hyrjes dhe daljes, etj., do të çmontohen dhe do të dërgohen në një kompani kompetente me licencë për trajtimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Ky aktivitet do të përfshijë dhe instalimet elektrike të nevojitura për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, të ngrohjes së ujit me anë të qelizave fotovoltaike të kulmit, me ashensorin e ri për pasagjerët.

Gjithsej, instalimet elektrike do të mbulojnë tërë hapësirën e shfrytëzueshme të hotelit, që arrin 897.35m<sup>2</sup>.

### **Prokurimi i mobilieve dhe pajisjeve tjera për dhomat**

Përmirësimet brenda hotelit do të vlejnë edhe për disenjin e brendshëm, kullën e ashensorit të ri, pajisjen dhe tërë imazhin e hotelit, pasi qëllimi i hotelit është ta përmirësojë eksperiencën e të ftuarve dhe mundësisht, të aplikojë për kategorinë e hotelit me 4 yje.

*Shembujt ku përfshihen përmirësimet në hotel:*



*Hapësira e lobit – Mobilie dhe karpentieri*

*Para dhe pas*



*Para dhe pas*



*Dhomat dhe apartamentet*

*Para dhe pas*

### **3. Kategoria mjedisore**

#### **3.1 Politikat/Kategorizimi i garancisë së Bankës Botërore**

PKLR është mbështetur me një grant të Bashkimit Evropian dhe po zbatohet bashkërisht nga Kabineti i Zëvendës Kryeministrit për Çështje Ekonomike, si agjenci implementimi i mjeteve financiare, dhe nga Banka Botërore. PKLR është klasifikuar si projekt i Kategorisë B, që do të thotë se mund të pritet një shkallë e caktuar e impaktit të pafavorshëm, si rezultat i implementimit të tij, megjithatë asnjëra nga ato shkallë nuk është në masë të konsiderueshme e shkallës së lart, apo afatgjatë. Si rezultat i këtij klasifikimi, është ngritur OP 4.01 Vlerësimi mjedisor. Si pasojë, Kabineti i Zëvendës Kryeministrit për Çështje Ekonomike zhvilloi një Kuadër të Menaxhimit Mjedisor dhe Shoqëror (KMMSH) për të bërë kujdesin e duhur për nën-projektet nëpërmjet të Komponentit 3 të skemës së grantit, për të përcaktuar pranueshmërinë dhe procedurat e skringut dhe vlerësimin mjedisor. Të gjitha aktivitetet e projektit (dhe nën-projektit) patjetër duhet të zbatohen me respektimin e KMMSH, politikat e BB dhe procedurat dhe normat e brendshme (më të rreptat do të mbizotërojnë).

Nën-projekti i propozuar është klasifikuar nën Kategorinë B – për faktin se impaktet e tij mjedisore në të ardhmen janë më pak të pafavorshme sesa ato të nën-projekteve të Kategorisë A dhe B+ duke marrë parasysh natyrën, madhësinë dhe vendndodhjen e tyre, si dhe tiparet e impakteve të mundshme mjedisore.

Kjo kategori do të kërkojë një vlerësim mjedisor (VM) për të vlerësuar çfarëdo impaktesh të mundshme mbi mjedisin jetësor, që lidhen me nën-projektin e propozuar, për të identifikuar

mundësitë potenciale mjedisore dhe për të rekomanduar masa që do të nevojiten për të parandaluar, minimizuar dhe zbutur impaktet e pafavorshme. Shtrirja dhe formati i VM do të ndryshojë, varësisht nga nën-projekti, por në esencë, do të jetë më e ngushtë se shtrirja e vlerësimit të impaktit mjedisor (VIM), kryesisht, në formë të PMMSH. Shtrirja e PMMSH është përcaktuar në Shtojcën D të KMMSH. Për nën-projektet që përfshijnë avancime të thjeshta, rehabilitim, apo përshtatje të godinave, do të shfrytëzohet Lista e Kontrollit të PMMSH (modeli është dhënë në Shtojcën F të KMMSH).

Kategoria B- do të përfshijë nën-projekte, të cilat gjithashtu: (a) përfshijnë huamarrje kapitale pune për prokurimin dhe/ose përdorimin e materialeve të rrezikshme (p.sh. benzinë), ose (b) do të bëjnë përmirësime që përfshijnë prokurimin e pajisjes/makinerisë që paraqet rrezik potencial për shëndetin ose sigurinë. Sipas ligjeve maqedonase, për llojet e nën-projekteve që bien nën Kategorinë B- nuk do të kërkohet VIM.

### **3.2 Vlerësimi mjedisor sipas legjislacionit të brendshëm**

Nën-projekti nuk i takon asnjë kategorie të Shtojcës I dhe Shtojcës II të Dekretit për përcaktimin e projekteve dhe krijimeve në bazë të të cilave paraqitet nevoja për zbatimin e procedurës së vlerësimit të impaktit mbi mjedisin (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. / 2005, nr. 109/2009). Në pajtim me Udhëzimet për zbatimin e procedurës për përcaktimin e nevojës, përcaktimin e shtrirjes dhe rishikimin e vlerësimit të impaktit mbi mjedisin në Republikën e Maqedonisë, për një projekt që nuk i takon as Shtojcës I e as Shtojcës II, vendimi në lidhje me procedurën për përcaktimin e nevojës për VIM është se nuk ka nevojë për një VIM.

Sido që të jetë, sipas udhëzimeve të Njësisë për Implementimin e Projektit (NJIP) të PKLR, në kuadrin e raportit të skringut mjedisor, parashtruesi i nën-projektit kishte paraqitur një Njoftim për synimin e implementimit të një projekti në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor – Drejtoria e Mjedisit Jetësor. Hoteli TIM’S SHPK, Shkup ka paraqitur një letër me Njoftim për Synimin në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) dhe ka marrë përgjigje më datë 30.11.2018 me një Mendim se nuk kërkohet procesi i vlerësimit të impaktit në mjedisin, e as përgatitja e një Elaborati për mbrojtje mjedisore për realizimin e këtij nën-projekti. Përgjigja/Mendimi i pranuar nga MMJPH është bashkëngjitur si shtojcë me këtë Listë Kontrolli të PMMSH.

## **4. PASQYRA E IMPAKTEVE**

Si rezultat i aktiviteteve të parashikuara të nën-projektit për rindërtimin e Hotelit TIM’S SHPK, Shkup, u identifikuan impaktet potenciale të numëruara më poshtë:

1. Rreziqet e mundshme negative për sigurinë dhe shëndetin dhe impaktet mbi popullsinë, shoferët dhe punëtorët (impaktet lokale afatshkurta që janë në kuadrin e vendndodhjes së rindërtimit, për shkak të:



- Mungesës së masave të shëndetit dhe sigurisë në punë gjatë punimeve të rindërtimit,
- Lëndimit që paraqitet në ose afër sipërfaqes së punimeve (p.sh. për shkak të mospasjes së veshmbathjeve apo pajisjeve mbrojtëse, apo për shkak të mangësive tjera të sigurisë),
- Mosrespektimit të standardeve të sigurisë dhe procedurave të punës,
- Menaxhimit joadekuat të qarkullimit dhe sigurimit të këmbësorëve.

2. Impakti mundshëm mbi cilësinë e ajrit dhe shkarkimeve në ajër nga mjetet motorike që transportojnë materiale dhe pajisje në lokacionin e nën-projektit dhe që transportojnë mbeturina jashtë sipërfaqes (impakti lokal, i kufizuar brenda lokacionit të rinovimit/përshtatjes, që shfaqet vetëm gjatë fazës së zbatimit), për shkak të:

- shkarkimeve të pluhurit nga transportimi i materialeve, menaxhimit të materialeve dhe punimeve ndërtimore,
- shkarkimit të tymit nga mjetet motorike dhe qarkullimi rrugor, si dhe shkakimit të ndryshimeve në qarkullimin ekzistues të trafikut në afërsi.

[Menaxhimi joadekuat i njësive të vjetra të ajrit të kondicionuar që do të hiqen mund të shkaktojë shkarkimin e substancave që lëshon ozoni dhe të gazrave të serrave \(CFC\).](#)

3. Shkarkimet e mundshme të vibracioneve dhe shqetësimet nga zhurma për shkak të mjeteve motorike të transportit që lëvizin nëpër qytet drejt lokacionit të rinovimit, si dhe vetë punimet (impaktet lokale që janë në kuadrin e sipërfaqes së rinovimit vetëm gjatë fazës së zbatimit).

4. Menaxhimi joadekuat i mbeturinave dhe grumbullimi dhe transporti i mbeturinave me vonesë. Mund të shfaqen impakte/efekte anësore të mundshme ndaj mjedisit dhe efekte të pafavorshme për shëndetin, si rezultat i gjenerimit dhe menaxhimit të llojeve të ndryshme të mbeturinave (parimisht mbeturinat e ndërtimit, siç janë mbetjet e kompensatës, qilimat, pëlhura, sfungjeri, mbetjet e pllakave të gipsit, si dhe drutë, metalet, plastika e qelqit, mobiliet, dyshekët, mbeturinat e rrezikshme, p.sh. mbeturinat elektronike dhe elektrike, pajisjet e fiksuara të ndriçimit, mbetjet e bojës, ngjitësve dhe paketimeve. Mbeturinat e paketimeve (kartoni dhe najloni) gjithashtu do të gjenerohen. Këto impakte janë lokale. Nëse nuk përcaktohet menaxhimi i duhur i mbeturinave gjatë fazës së punës, ekziston mundësia që impaktet negative të jenë të gjata e me shfaqje të përsëritur, por të jenë brenda menaxhimit joadekuat të mbeturinave dhe grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave komunale me vonesë. [Është i mundur gjenerimi i mbeturinave hazardë \(p.sh. mbetjet e llakut dhe paketimeve\).](#)

6. Impaktet në tokën dhe ujin nga pikimet dhe derdhjet aksidentale dhe menaxhimi joadekuat i mbeturinave hazardë. Megjithatë, aktivitetet e parashikuara pritet që të shkaktojnë vetëm impakte të vogla në mjedisin, të cilat janë të përkohshme, lokale, afatshkurta dhe që kufizohen brenda periudhës së rinovimit/rindërtimit. Sasitë e pritura të materialeve të forta dhe të lëngshme hazardë që do të përdoren ose do të gjenerohen si mbeturina gjatë implementimit të nën-projektit janë të vogla.

**Nuk pritet asnjë impakt në burimet fizike kulturore ose habitatet natyrore, pasi që nën-projekti nuk gjendet në/në rrethinën e natyrës dhe/ose në zonat apo objektet e mbrojtura kulturore.**

Skriningu preliminar tregoi se mbetjet e azbestit dhe mbetjet e rrufepritisve radioaktivë, me siguri nuk do të gjenerohen në kuadrin e këtij nën-projekti, megjithatë, janë inkuadruar masa të zbutjes për kësaj rastesh.

## 5. QËLLIMI I LISTËS SË KONTROLLIT TË PMM, KUSHTET E ZBULIMIT

Banka Botërore kërkon Vlerësimin e Mjedisit (VM) për projektet e propozuara për financim nga Banka Botërore për të siguruar se ato janë të mbështetura dhe të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore, në mënyrë që të përmirësohet vendimmarrja. VM është një proces gjerësia, thellësia dhe lloji i analizës së të cilit varen nga natyra, shtrirja dhe impaktet e mundshme të projektit të propozuar në mjedisin jetësor. VM vlerëson rreziqet e mundshme për mjedisin që do të ishin shkaktuar nga projekti, si dhe impaktet e tyre në zonën që është përfshirë me projektin.

Sipas skringut të zbatuar të Aplikimit për Shprehjen e Interesit, ky projekt u kategorizua me B-. Nën-projektet janë klasifikuar me kategorinë B-. Impaktet potenciale mbi mjedisin jetësor janë më pak të dëmshme sesa nën-projektet e kategorisë A dhe B+, duke ditur natyrën, madhësinë dhe lokacionin e tyre, si dhe tiparet e impakteve potenciale mbi mjedisin.

Shtrirja e vlerësimit mjedisor për nën-projektet mund të ndryshojë për nën-projektet e ndryshme, por është zakonisht më e vogël se shtrirja e Vlerësimit të Impaktit mbi Mjedisin, më së shpeshti në formën e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Shoqëror (PMMSH). Për nën-projektet që parashikojnë avancime të thjeshta, rinovime ose përshtatje të objekteve, përdoret Lista e Kontrollit të PMMSH. Forma e Listës së Kontrollit të PMMSH përcaktohet nga Korniza Mjedisore dhe Shoqërore për Projektin për Konkurrueshmëri Lokale dhe Rajonale.

Lista e Kontrollit të PMMSH aplikohet për rehabilitime të vogla, apo ndërtime godinash me vëllim të vogël. Ajo ofron “praktikë të mirë pragmatike” dhe është zhvilluar që të jetë miqësore për përdoruesin dhe është në pajtim me kushtet e sigurisë të BB. Format i llojit të listës së kontrollit orvatet të përfshijë qasjet e zbutjes që janë tipike për kontratat e punëve ndërtimore me impakte të lokalizuara.

Lista e Kontrollit ka një paragraf hyrës (Pjesa e Hyrjes, ku përshkruhet projekti, pjesa ku përkufizohet kategoria mjedisore, identifikohen impaktet, dhe sqarohet koncepti i Listës së Kontrollit të PMMSH), dhe tre pjesë kryesore:

- **Pjesa 1** përbën pjesën e përshkrimit (“pasaporta e sipërfaqes”), në të cilën përshkruhen specifikat e projektit në kuptimin e lokacionit fizik, aspektet institucionale dhe legjislative, përshkrimi i projektit, duke përfshirë nevojën për një program të ndërtimit të kapaciteteve, si dhe përshkrimin e procesit të këshillimit publik.
- **Pjesa 2** përfshin një skringing mjedisor dhe shoqëror, në një format të thjeshtë Po/Jo, i vijuar nga masat e zbutjes për secilin aktivitet.
- **Pjesa 3** është një plan monitorimi për aktivitetet gjatë ndërtimit dhe implementimit të projektit. Ajo mban të njëjtin format që kërkohet për PMMSH standarde të Bankës Botërore. Synimi i kësaj liste të kontrollit është që Pjesa 2 dhe Pjesa 3 të inkuadrohen si dokumente tenderi për kontraktuesit.

Procedura për publikimin e Listës së Kontrollit të PMMSH është si vijon: Lista e Kontrollit e PMMSH në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze duhet të publikohet në ueb faqen e PKLR dhe të pranuesit, si dhe në ueb faqet e komunës së prekur dhe do të vihet në dispozicionin e publikut për të paktën 14 ditë. Duhet qenë e disponueshme në kopje letre në hapësirat e PKLR dhe në komunat relevante dhe/ose në qendrat e rajoneve planore. Kur do të shpallet, thirrja për vërejtje ndaj dokumenteve do të lëshohet në adresën e disponueshme elektronike dhe postare, për dërgimin e vërejtjeve. Evidenca e dëgjimit publik (komentet dhe pyetjet e mbledhura) përmban informacionet bazë për vendin, listën e personave të pranishëm dhe përmbledhjen e vërejtjeve të pranuar dhe duhet të përfshihet në versionin final të dokumentit të publikuar.

## 6. APLIKIMI I LISTËS SË KONTROLLIT TË PMMSH

Lista e Kontrollit e PMMSH është një dokument i përgatitur nga, dhe në pronësi të përfituesit. Disenji dhe procesi i implementimit për nën-projektin do të shtjellohet në tre faza:

1. *Faza e identifikimit të përgjithshëm dhe vendosjes së shtrirjes*, në të cilën përzgjidhet objekti për rinovim/ndërtim me përmasë të vogël/përshtatje dhe elaborohet një program i përafërt për tipologjitë potenciale të punës. Në këtë fazë, Pjesët 1, 2 dhe 3 të Listës së Kontrollit të PMMSH mund të shfrytëzohet për të përzgjedhur aktivitetet tipike nga “menyja” dhe të lidhen me çështjet tipike mjedisore dhe masat e zbutjes. Bëhen këshillime publike, dhe finalizohet PMMSH.
2. *Faza e planifikimit të detajuar dhe të tenderimit*, duke përfshirë specifikime dhe paramatje për punimet ndërtimore, pajisje, shërbime marketingu dhe shërbime tjera për nën-projektin. **Lista e Kontrollit e PMMSH do të bashkëngjitet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të tenderit dhe të kontratës së punës, si dhe të kontratës së mbikëqyrjes, dhe, në analogji me të gjitha kushtet teknike dhe komerciale, duhet të nënshkruhen nga palët kontraktuese.**
3. *Gjatë fazës së zbatimit të punimeve*, respektimi i mjedisit (konform Listës së Kontrollit të PMMSH dhe normave ligjore mbi shëndetin dhe sigurinë) dhe kriteret tjera kualitative do të zbatohen në sipërfaqen konkrete dhe aplikimi do të kontrollohet/mbikëqyret nga mbikëqyrësi i sipërfaqes, që do të thotë inxhinieri

mbikëqyrës apo mbikëqyrësi i projektit i caktuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Listës së Kontrollit të PMMSH. Masat e zbutjes në Pjesën 2 dhe Plani i Monitorimit në Pjesën 3 janë baza për përcaktimin e përshtatjes së Kontraktuesit ndaj dispozitave të domosdoshme mjedisore.

Zbatimi praktik i Listës së Kontrollit të PMMSH do të përfshijë arritjen e Pjesës I për pasjen dhe dokumentimin e të gjitha specifikave që janë relevante për sipërfaqen. Në Pjesën II, aktivitetet që do të zbatohen, do të kontrollohen sipas llojit të parashikuar të aktivitetit, ndërsa në Pjesën 3, parametrat e monitorimit do të identifikohen dhe aplikohen sipas aktiviteve të prezantuara në Pjesën 2.

E tërë Lista e Kontrollit e PMMSH e plotësuar në tabelë (Pjesët 1, 2 dhe 3) për çdo lloj të punës, do të bëhet pjesë përbërëse e kontratave të punës, në analogji me të gjitha kushtet teknike dhe komerciale, të cilat duhet të nënshkruhen nga palët kontraktuese.

## 7. MASAT E ZBUTJES

Masat për shmangien dhe reduktimin/zbutjen e impakteve të identifikuarra për mjedisin jetësor, punëtorët dhe komunitetet, dhe aspektet shoqërore të nën-projektit që do të aplikohen në kuadrin e nën-projektit, janë këto më poshtë:

Shënimi me rregull i sipërfaqes për rinovim/përshtatje/ndërtim me vëllim të vogël, shënimi i lokacionit përkatës për magazinim të përkohshëm të materialeve ndërtimore në sipërfaqe, shiritat e paralajmërimit, gardhet dhe shenjat, ndalesa e hyrjes për personat e papunësuar brenda shiritave të paralajmërimit, aplikimi i masave të sigurisë për qytetarët, makinat që do të drejtohen vetëm nga personeli me përvojë dhe i trajnuar, prezenca e vazhdueshme e pajisjeve zjarrfikëse në rast të zjarrit apo dëmit tjetër, mbajtja e pajisjes dhe veshmbathjeve mbrojtëse gjatë gjithë kohës, fiksimi i skelave, dhe masa tjera për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë, lëngjet e ndezshme mund të vendosen dhe të ruhen vetëm në enë të disanjuara për atë qëllim.

Të gjithë punëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet e zjarrit dhe masat zjarrfikëse dhe patjetër duhet qenë të trajnuar për të manovruar aparatet zjarrfikëse, hidrantët dhe mjetet tjera që përdoren për fikjen e zjarreve, të cilat duhet qenë në funksion.

Niveli i zhurmës nuk duhet të kalojë 55dB gjatë ditës, dhe 45dB gjatë natës dhe punimet ndërtimore nuk do të zbatohen gjatë natës (orët e rinovimit 07.00 deri në 19.00).

Identifikimi, klasifikimi dhe magazinimi i përkohshëm i hequr mënjandë (në kosh/konteinerë plehrash në një lokacion të veçuar dhe të përcaktuar paraprakisht në sipërfaqe dhe ato duhet qenë në numër të mjaftueshëm) të llojeve të ndryshme të mbeturinave të cilat mund të gjenerohen nga rinovimi dhe trajtimi si duhet i mbeturinave. Mbeturinat mund të transportohen dhe depozitohen/procesohen vetëm nga kompani të licencuara.

Vendosja e një regjimi të posaçëm të qarkullimit të mjeteve motorike të kontraktuesit gjatë periudhës së rinovimit, me një sinjalizim përkatës.

Firmosja e kontratës me një kompani shërbimi për mirëmbajtje të rregullt, zhvendosja e pjesëve rezervë, ndryshimet parandaluese të lubrifikantit, mirëmbajtja përkatëse (nxjerrja e tymit dhe siguria, p.sh., frenat, gomat, etj.), si njëri nga funksionet më me rëndësi për sigurinë, etj., larja e rregullt e mjeteve motorike dhe mbajtja e pastërtisë në zonën e parkingut, ndalimi i zëvendësimit të vajit të motorit në zonën e parkingut, për të shmangur vajin dhe ndotjen e ujërave dhe tokës, zbatimi i testit të rregullt vjetor të aprovimit gjatë regjistrimit vjetor të mjeteve motorike.

Masat e zbutjes të përshkruara në këtë paragraf janë masa të përgjithshme, ndërsa masat e detajuara dhe të detyrueshme të zbutjes janë dhënë në Tabelën: Lista e Kontrollit të Masave të Zbutjes (Pjesa 3).

## 8. PROCEDURAT E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT DHE SHPËRNDARJA E PËRGJEGJËSIVE

Për monitorimin e zbatimit të Listës së Kontrollit të PMMSH, mbikëqyrësi i sipërfaqes apo personi përgjegjës i caktuar nga Përfituesi (në rast të punimeve që nuk kërkojnë angazhimin e një inxhinieri mbikëqyrës; mbikëqyrësi i sipërfaqes në tekstin e mëposhtëm), do të veprojë me Pjesën 2 dhe Pjesën 3 të Listës së Kontrollit të PMMSH, përkatësisht, me planin e monitorimit. Pjesa 2 dhe 3 janë zhvilluar në detajet e domosdoshme, duke përcaktuar masat e qarta të zbutjes dhe monitorimin, që mund të përfshihen në kontratat e punës, që reflekton statusin e praktikës mjedisore në sipërfaqen e punimeve dhe i cili mund të observohet/kuantifikohet/verifikohet nga mbikëqyrësit përgjatë punimeve.

Pjesa 3 praktikisht reflekton kriteret kryesore të monitorimit sipas masave të dhëna të zbutjes, të cilat mund të kontrollohen përgjatë dhe pas punimeve për të siguruar përputhjen dhe në fund, pagimin e Kontraktuesit.

Masat e tilla të zbutjes përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, përdorimin e pajisjes personale mbrojtëse (PPM) nga punëtorët në sipërfaqe, gjenerimin dhe parandalimin e pluhurit, sasinë e ujit që përdoret dhe shkarkohet në sipërfaqe, trajtimin e ujërave të zeza, prezencën e objekteve të përshtatshme sanitare për punëtorët, grumbullimin e mbeturinave të llojeve të ndryshme (dru, metale, plastikë, mbeturina hazarde, p.sh., mbetjet e ngjitësit dhe bojës dhe paketimeve, llambat elektrike), sasinë e mbeturinave, organizimi si duhet i shtigjeve të heqjes së mbeturinave dhe objekteve, apo ripërdorimi dhe riciklimi kudo që të jetë i mundur. Përveç masave të Pjesës 3, mbikëqyrësi duhet të kontrollojë nëse kontraktuesi vepron në pajtim me masat e Pjesës 2. Raportimi mbi zbatimin e praktikave duhet të përshkruhet në raportin e rregullt që i parashtrohet Njësisë së Implementimit të Projektit (NJIP).

Një raport i pranueshëm monitorimi nga kontraktuesi apo mbikëqyrësi i sipërfaqes duhet qenë kusht për pagimin e plotë të hakut të dakorduar me kontratë, njëjtë si dhe kriteret teknike të cilësisë, apo sondazhet e cilësisë. **Raportimi mbi zbatimin e Listës së Kontrollit të PMMSH do të jetë tremujor (nëse nuk është dakorduar ndryshe me NJIP, [që është](#)**

**lëndë e miratimit të BB**). Për të siguruar sistemin e levave për punën mjedisore të Kontraktuesit, do të inkuadrohet një klauzolë përkatëse në kontratat e punës, ku do të specifikohen gjobat në rast të mospërputhjes me dispozitat mjedisore kontraktuale, p.sh. në formën e mbajtjes së një përqindjeje të pagesave përderisa të aplikohen masat korigjuese dhe të vihet në përputhje me ato dhe nën-projektin, madhësinë e tij, varësisht nga madhësia e shkeljes së kontratës. Për rastet ekstreme, ndërprerja e kontratës duhet të përcaktohet me vetë kontratën.

Zbatimi i masave të përcaktuara me Listën e Kontrollit të PMMSH do të vëzhgohet nga mbikëqyrësi/inxhinieri mbikëqyrës, inspektori i autorizuar dhe/ose inspektori shtetëror mjedisor dhe komunal, si dhe eksperti i mjedisit nga Njësia e Implementimit të Projektit. Zbatimi i masave do të ndiqet përpara fillimit të punimeve, gjatë rinovimit dhe pas kompletimit të tyre.

Parashtruesi (t) detyrohet rregullisht të parashtrojë raporte mbi zbatimin dhe monitorimin e masave mjedisore të zbutjes (raportet e zbatimit të Listës së Kontrollit të PMMSH, p.sh. në formën e pasqyrës tabelore (tabelat e planit të zbutjes dhe planit të monitorimit), me një kolonë plotësuese ku do të jepet statusi i masave, observimet dhe komentet, si dhe monitorimi i masës (i zbatuar / jo i zbatuar, rezultatet, observimet, komentet, shqetësimet, kur, etj.).

<b>Pjesa 1: Çështjet institucionale dhe administrative</b>	
Vendi	Republika e Maqedonisë
Titulli i nën-projektit	Hotel TIM'S apartments, Shkup – rindërtim dhe përmirësim
Shtirirja e nën-projektit dhe aktivitetet konkrete	Menaxhimi dhe koordinimi i nën-projektit; Rindërtimi i një gjysmë kati plotësues dhe hapja e një kulle të ashensorit; Përmirësimi i hapësirave të akomodimit; Prokurimi i pajisjes për dhomat, recepcionin, restorantin, hapësirën e konferencave;
Aranzhimet institucionale (Emri dhe kontaktet)	<b>Menaxhmenti i Projektit*</b>
	<u>Investuesi:</u> Hotel TIM'S SHPK, Shkup Rr. "Orce Nikollov" Nr. 120, 1000 Shkup
	<u>Koordinatori i nën-projektit:</u> TIM-Inzhenering SHPKNJP, Shkup Bul. "Mitropolit Teodosij Golloganov Nr. 60b", 1000 Shkup <a href="mailto:timing@tims.com.mk">timing@tims.com.mk</a>
Aranzhimet e implementimit (Emri dhe kontaktet)	<b>Mbikëqyrja**</b>
	Do të shtohet në një fazë të mëvonshme, pasi të bëhet përzgjedhja e kontraktuesit dhe inxhinierit mbikëqyrës.
<b>Përshkrimi i sipërfaqes</b>	
Emri i sipërfaqes	<b>Rr. Orce Nikollov Nr. 120, Shkup</b>
Përshkrimi i vendndodhjes së sipërfaqes Shtojca 1: Informacionet e sipërfaqes (numrat nga sipërfaqja) <input checked="" type="checkbox"/> Po ose <input type="checkbox"/> Jo	Hoteli TIM'S gjendet në rr. Orce Nikollov nr. 120, në komunën Qendër të Shkupit. Hoteli është i aksesueshëm me automjetet nëpër parkingun privat nga rr. Orce Nikollov dhe nëpër rrugën e këmbësorëve. Hoteli TIM'S është regjistruar me rregull në Planin e Detajuar Urbanistik: 483/2014, kuarti i qytetit Debar Maallo 1, Parcela 1.19. Ndërtesa gjendet në parcelën kadastrale 5137, komunën kadastrale Qendër 1, dhe ka Certifikatën e Pronësisë B5- komplekset hotelierike.
Kush është pronari i tokës?	TIM'S SHPK Shkup
Përshkrimi gjeografik	Vendi: Republika e Maqedonisë Qyteti: Shkup Komuna: Qendër Rajoni: Debar Maallo 1 Koordinatat: 42°00'10.8"N 21°25'05.0"E
<b>Legjislacioni</b>	
